



► E-KONSULLATA ËSHTE MËNYRA MË E THJESHTË DHE MË E SHPEJTË PËR TU INFORMUAR NË LIDHJE ME SHËRBIMET E SHTETIT SHQIPTAR



► KËLQIET QENDRA KOMBËTARE E LIBRIT DHE LEXIMIT, LIBRI TA SHMË KA NJË INSTITUCION ZYRTAR I CILI DO TË NXIJE DHE PROMOVOJË LIBRIN, AUTORËT DHE PËRKËTHYESIT SHQIP TËRE BRENDA DHE JA SHTE VENDIT



► PARAQITËT NË KOMISION PROJEKTUJË "DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 139/2015," PËR GEVERISJEN VENDORE

NEWSLETTER E DIASPORËS



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

#3

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Hapet procesi i regjistrimit "on-line" për Samitin e Dytë të Diasporës

Për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të bëhen pjesë e Samitit të Dytë të Diasporës, sot realizohet procesi i regjistrimit "on-line". Regjistrimi kryhet në faqen elektronike të Samitit. Për marrjen e ftesës "on-line" duhen plotësuar të dhëna të përgjithshme të individit, si vendi i lindjes, rezidenca dhe kontaktet. Në formularin e regjistrimit keni mundësinë të shprehni interes për të ndjekur diskutimin në një nga panelet e Samitit.

Për regjistrimin "on-line" në Samitin e Dytë të Diasporës klikoni në link-un e mëposhtëm:

> <http://samiti.diaspora.gov.al/regjistrohu-ne-samit-2> <

Komititeti Shtetëror për Diasporën, Ministri Majko prezanton programin e Samitit

Komititeti Shtetëror për Diasporën mbajti sot mbledhjen e radhës ku ministri i Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko prezantoi programin e plotë të Samitit të Dytë të Diasporës, i cili do të zhvillohet më 28 shkurt – 2 mars. Tema e takimit u përqendrua tek panelet e diskutimit të Samitit të cilat do të trajtojnë çështje thelbësore të Diasporës.

Programi i Samitit parashikon realizimin e katër paneleve të diskutimit të cilat do të zhvillohen paralelisht.

Në panelin e parë do të trajtohet tema "Vota si e drejtë", ndërsa fokusi i panelit të dytë do të jetë te ekonomia, ku do të trajtohet tema "Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm - Vendlindja dhe Diaspora". Paneli i tretë do të ketë në fokus të diskutimit "Identitetin shqiptar". Në panelin e katërt me temë " Ftesë nga shtëpia juaj", do të analizohen aspekte të ndryshme të turizmit dhe agroturizmit.

Gjithashtu në mbledhje u prezantuan dhe aktivitetet kulturore dhe artistike që do të realizohen gjatë Samitit në Tiranë dhe në Lezhë.



Publikohet ftesa e Kryeministrit, Edi Rama për Samitin e Dytë të Diasporës

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë z.Edi Rama u ka drejtuar një ftesë të hapur përfaqësuesve të Diasporës për të marrë pjesë në Samitin e Dytë të Diasporës.

Ftesa u është drejtuar personaliteteve të Diasporës të cilët kanë marrë pjesë në Samitin e parë.

Duke pasur parasysh interesimin e madh për pjesëmarrje në Samitin e Dytë të Diasporës, sot nisi regjistrimi "on-line".

Libri "Politika Shtetërore për Diasporën" prej ditës së sotme mund të lexohet i plotë on-line

Libri "Politika Shtetërore për Diasporën" prej ditës së sotme mund të lexohet i plotë në faqen elektronike të Ministrisë të Shtetit për Diasporën, në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Ky libër përmbledh të plotë kornizën e re ligjore që nga krijimi i institucioneve shtetërore, shtimi i burimeve financiare, materiale e njerëzore për këtë qëllim etj.

Libri është i vendosur sipas formatit klasik të një libri, në mënyrë që të shfletohet lehtësisht. Materialet e paraqitura në këtë botim, shërbejnë për informimin e shtetasve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit mbi ecurinë e detajuar të strukturave shtetërore dhe legjisllacionit të ri për marrëdhëniet me Diasporën shqiptare.

Reforma e politikave shtetërore në fushën e Diasporës mbështetet në kërkesat imediate për implementimin e plotë të dispozitivave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë por edhe me promovimin e angazhimit të

Diasporës me vendin e origjinës si dhe qasjen drejt një ndërgjegjeje evropiane për rëndësinë e Diasporës në ndërtimin e urave lidhëse midis vendeve pritëse dhe vendit të origjinës etj.

28

SHKURT

SAMITI II "I" DIASPORËS

- 14:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve në Samit [Shfaq](#)
- 19:00 Mbrëmje në Tiranë - Ceremonia e mbyrtjes së pjesëmarrësve në Samit [Shfaq](#)
- 20:30 Mbrëmje e lirë [Shfaq](#)

01

MARS

SAMITI II "I" DIASPORËS

- 09:00 Nisja drejt vendit ku do të mbahet Samiti [Shfaq](#)
- 09:30 Mbrëmje në Shqipëri e Diasporës [Shfaq](#)
- 10:00 Sesion Kuvendues Pënar i Diasporës Shqiptare me Pjesëmarrjen e Autoriteteve Zyrtare [Shfaq](#)
- 11:15 Pushim kafje [Shfaq](#)

SAMITI II "I" DIASPORËS

- 11:30 Pande Diskutimi Paralele [Shfaq](#)
Vota si e drejtë!
Politika e Re Shtetërore për Diasporën
Diaspora dhe të drejtat e saj në shtetësi
Zhvillimi Ekonomik i Qëndrueshëm Vendlindja dhe Diaspora
Ekonomia, Ekonomikimi, Injenerizimi
Identiteti Shqiptar
E ardhmja e librit nga Diaspora!
Arta, Kultur, Arti dhe Jentropia
e Arteve Scenike
Ftesë nga Shtëpia Juaj
Turizmi, Agroturizmi

SAMITI II "I" DIASPORËS

- 13:30 Sesion Përmbyllës
Konkluzimet e Diskutimeve dhe Dokumentet Përfundimtarë i Samitit
Nis hapësirë e dialogut në RMK [Shfaq](#)
- 15:00 Nisja drejt vëndve të drektës [Shfaq](#)
- 18:30 Mbrëmje në Mbrëmjen Gala [Shfaq](#)
- 19:00 Mbrëmje Gala e Samitit II të Diasporës Shqiptare
Përkrahja e Lindjes "Shqiptarë e Artë e Diasporë"
Njëkohshërisht "Mbështetës e Kombit" [Shfaq](#)
- 20:30 Darkë e lirë [Shfaq](#)

02

MARS

SAMITI II "I" DIASPORËS

- 09:30 Nisja drejt Lezhës [Shfaq](#)
- 12:00 Ceremonia e 575-vjetorit të besëlidhjes në Lezhë [Shfaq](#)
- 13:00 Darkë buletë në oder të pjesëmarrësve në Samit nga Kryetari i Bashkisë Lezhë [Shfaq](#)
- 15:30 Nisja drejt Tiranës [Shfaq](#)
- 17:30 Mbrëmje në Tiranë [Shfaq](#)
- 18:00 Darkë e lirë [Shfaq](#)

